



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 17.3.2025

Nr: 278

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR PËRCAKTIMIN E RENDITJES SË
SUBJEKTEVE ZGJEDHORE NË FLETËN E VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR
KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 98, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 10, datë 11.3.2021, të Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për Kuvend”,

V E N D O S:

1. Miratimin e rezultatit të shortit, duke përcaktuar numrin rendor që do të ketë çdo subjekt zgjedhor në fletën e votimit, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 17.3.2025 Nr: 278
Ora: 13:00



“Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”

LIDHJA 1

SHORTI PËR NUMRIN RENDOR TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE NË FLETËN E VOTIMIT

1. KOALICIONI “PARTIA DEMOKRATIKE- ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE”
2. PARTIA “LËVIZJA BASHKË”
3. LËVIZJA “ATDHEU”
4. PARTIA “KOALICIONI EUROATLANTIK”
5. “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”
6. KOALICIONI “NISMA SHQIPËRIA BËHET- ADRIATIK LAPAJ”
7. PARTIA “ALEANCA KOMBËTARE SHQIPTARE”
8. PARTIA “ALEANCA DEMOKRACIA E RE”
9. KOALICIONI “DJATHHTAS PËR ZHVILLIM”
10. PARTIA “MUNDËSIA”
11. “PARTIA SOCIALDEMOKRATE”.